FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 45	2000	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8691 datë 16.11.2000	Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve	1991
Ligj nr.8701 datë 1.12.2000	Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet	1996
Ligj nr.8704 datë 1.12.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për konsolidimin e borxhit (në bazë të termave të referencës së "Klubit të Parisit")"	2006
Ligj nr.8708 datë 1.12.2000	Për disa përjashtime dhe për dhënien e disa stimujve për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit me koncension të formës "BOT"	2010
Ligj nr.8709 datë 6.12.2000	Për miratimin e "Kontratës për shitjen e aseteve të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë Krujë"	2012
Dekret nr.2839 datë 21.12.2000	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	2020
Vendime të K.K.R.T	Për dhënie licence	2021

L I G J
Nr.8691, datë 16.11.2000

PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E DUHANIT DHE TË CIGAREVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 paragrafi 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin e duhanit të papërpunuar, përpunimin industrial, tregtimin e duhanit të përpunuar dhe të produkteve të tij në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Mbikëqyrja dhe kontrolli i prodhimit dhe i tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij realizohet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Ministria e Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontrollon anën fiskale.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji:

"Duhan" nënkupton gjethen e bimës së kultivuar të specieve Nikotiana tabacum, në të gjitha format dhe stadet e rritjes, të përpunimit dhe të manipulimit, kur nuk përdoren për konsum final.

"Prodhim bujqësor i duhanit" nënkupton prodhimin e farës, të fidaneve të duhanit, rritjen e tij në fushë, vjeljen, tharjen dhe manipulimin e duhanit nga prodhuesit.

"Përpunim industrial i duhanit" nënkupton klasifikimin, manipulimin, heqjen e kërcellit për duhanet gjethemëdha, fermentimin ose trajtimin termik dhe përgatitjen e duhanit për tregtim.

"Tregtim duhani" nënkupton shitblerjen e duhanit në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit deri në shpërndarjen e tij si produkt gjysmë i gatshëm (duhan i përpunuar).

"Produkte duhani" nënkupton cigaret, puretat, purot, duhanet për llullë, duhanin kaush, burnotin dhe duhanin për përtypje.

KREU II
PRODHIMI BUJQËSOR DHE TREGTIMI I DUHANIT
TË PAPËRPUNUAR

Neni 4

Prodhuesit e duhanit prodhojnë gjethe duhani për treg, mbi bazën e kontratës së shkruar të prodhimit, me persona juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj, të regjistruar si grumbullues e përpunues industrialë të duhanit në regjistrat e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe. Këto subjekte pajisen me leje grumbullimi nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 5

Prodhimi, kontrolli, çertifikimi dhe shpërndarja e farës së duhanit bëhet nga institucionet

shkencore dhe nga ente të tjera, të njohura dhe të miratuara nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Farërat dhe fidanet e duhanit shpërndahen nga persona juridikë dhe fizikë, të cilët përfshihen në regjistrin e grumbulluesve dhe të përpunuesve të duhanit.

Neni 6

Për prodhimin e fidaneve të duhanit përdoren vetëm farëra që janë prodhuar dhe certifikuar në përputhje me rregulloret e prodhimit të farërave bujqësore të vendit dhe të huaja dhe janë të regjistruara në katalogun zyrtar të farërave dhe të fidanëve të Republikës së Shqipërisë, pranë Entit Shtetëror të Farërave dhe të Fidanëve.

Neni 7

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit përcakton dhe miraton rajonizimin e kultivimit të nëntipeve të duhanit për të gjithë vendin. Strukturat në varësi të saj bëjnë rajonizimin dhe përcaktimin e llojeve të prodhimit të duhanit, sipas kushteve agroklimatike.

Neni 8

Kultivimi i duhanit kryhet sipas udhëzimeve metodike, të miratuara nga institucionet shkencore përkatëse, të cilat përgatiten në përshtatje me kërkesat ekzistuese, që sigurojnë ruajtjen e mjedisit dhe pastërtinë e prodhimit të duhanit.

Neni 9

1. Prodhuesit e duhanit, çdo fillim viti, brenda datës 31 maj, bëjnë deklaratën me shkrim, në strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rreth, me të dhënat faktike për vendin e prodhimit, sipërfaqen, tipin, llojin dhe prodhimin e pritshëm të duhanit.

2. Pranë këtyre strukturave mbahet regjistri i prodhuesve të duhanit dhe i sipërfaqeve të kultivuara me duhan.

Neni 10

Vlerësimi cilësor i duhanit kryhet nga prodhuesi, grumbulluesi dhe/ose përpunuesi industrial i duhanit, mbështetur në standardet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Prodhuesit e duhanit, grumbulluesit dhe përpunuesit industrialë të tij i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, duke lidhur kontratat përkatëse të prodhimit dhe të tregtimit të duhanit, të cilat, paraprakisht, nënshkruhen dhe/ose për prodhimin e ardhshëm sezonal.

Neni 12

Nga prodhuesit duhani tregtohet i tharë, i manipuluar në dengje fshati.

Neni 13

Të dhënat për duhanin e shitur, në sasi dhe vlerë, deklarohen nga grumbulluesit dhe regjistrohen në regjistrin e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethet përkatëse.

KREU III
PËRPUNIMI INDUSTRIAL DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 14

1. Përpunimi industrial dhe prodhimi i produkteve të duhanit kryhet nga persona juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, të pajisur me leje përpunimi dhe/ose prodhimi nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Leja, sipas pikës 1, u jepet personave fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që plotësojnë kushtet teknike dhe teknologjike për përpunimin industrial dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit ose që kanë kontratë për përpunim industrial dhe/ose prodhim të produkteve të duhanit me subjekte që plotësojnë kushtet e mësipërme, me të drejtë ripërsëritjeje.

Kriteret për dhënien e lejes së përpunimit industrial dhe/ose të prodhimit të produkteve të duhanit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit regjistrojnë markat e tyre në Regjistrin e Markave pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit. Për vlerësimin cilësor të markave të produkteve të duhanit, të pranishme në tregun shqiptar, krijohet pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Komisioni i Ekspertëve të Degustimit të Duhan-Cigareve, i cili emërohet nga Ministri i kësaj Ministrie.

Procedura e regjistrimit, numri i anëtarëve të Komisionit të Ekspertëve të Degustimit të Duhan-Cigareve, kriteret e emërimit të tij dhe të drejtat e detyrat e këtij Komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV
TREGTIMI I DUHANIT TË PËRPUNUAR DHE I PRODUKTEVE TË TIJ

Neni 16

Duhani tregtohet i manipuluar, sipas cilësive, në dengje industriale dhe i fermentuar.

Neni 17

Produktet e duhanit, të prodhuesve të vendit ose të importit, të pranishme në tregun shqiptar, tregtohen vetëm me pullë fiskale, të ngjitur në ambalazhin përdorues, nën letrën e tejdukshme të paketës.

Neni 18

Personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë duhan të përpunuar dhe produkte të tij vendosin detyrimisht në mjedisin e tregtimit tabela në gjuhën shqipe: “Cigare”, “Produkte të duhanit”, “Pirja e duhanit dëmton shëndetin”.

Neni 19

Ndalohet tregtimi i duhanit për konsum dhe i produkteve të tij:

a. Cigare jashtë paketës (të hapura);

b. me prejardhje dhe prodhues të panjohur;

c. me dëmtime dhe defekte që prishin cilësinë përdoruese.

Neni 20

Ndalohet reklama e çdo forme të tregtimit të duhaneve dhe të produkteve të tij në median e shkruar dhe elektronike.

KREU V
AGJENCIA KOMBËTARE E DUHAN-CIGAREVE DHE FONDI DUHAN

Neni 21

1. Për nxitjen, zhvillimin dhe garancinë e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij, krijohet Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve.

Kjo agjenci është institucion shtetëror me statusin e personit juridik publik, pa qëllim fitimi, në vartësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Për zbatimin e detyrave dhe të funksioneve që ka Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, krijohet "Fondi i duhanit", i cili administrohet nga kjo Agjenci.

3. Mjetet e "Fondit të duhanit" krijohen nga këto burime:

a) 2 për qind e të ardhurave të realizuara nga shitja e duhanit të fermentuar, si dhe 2 për qind nga të ardhurat e realizuara nga shitja e produkteve të duhanit. Këto kuota janë të detyrueshme për t'u paguar nga çdo person fizik dhe juridik, përpunues dhe importues dhe kalojnë në ngarkim të kostos.

b) 60 për qind e të ardhurave që krijohen nga derdhja e gjobave, sekuestrimeve dhe sanksioneve të tjera që rrjedhin nga ky ligj. 40 për qind e të ardhurave nga gjobat, sekuestrimet dhe sanksionet të tjera derdhen në buxhetin e shtetit.

c) dhurime, ndihma dhe mjete të tjera të dhëna nga dhurues të ndryshëm dhe nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Mjetet e fondit përdoren për këto qëllime:

a) për sigurimin e farës ose të fidanëve të duhanit dhe për prodhuesit e duhanit, sipas nenit 9 të këtij ligji;

b) për politika të caktuara të shtetit për zhvillimin e sektorit të duhanit.

Fillimi i veprimtarisë, mënyra e organizimit dhe funksioni i kësaj Agjencie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 22

Kur nuk përbëjnë vepra penale, shkeljet e mëposhtme, të kryera nga një person fizik ose juridik, janë kundërvajtje administrative:

a) Tregtimi i duhanit të papërpunuar nga subjekte, në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 20 mijë deri në një milion lekë, me sekuestrimin e sasisë së duhanit dhe/ose heqjen e lejes përkatëse.

b) Prodhimi i produkteve të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 10 mijë deri 400 mijë lekë dhe me sekuestrimin e makinerive, të pajisjeve, të lëndës së parë, të materialeve ndihmëse dhe të prodhimit të gatshëm.

c) Tregtimi i produktit të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 5 mijë deri 20 mijë lekë, sekuestrimin e produkteve të duhanit dhe/ose heqjen e lejes përkatëse.

ç) Reklama e tregtimit të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 200 mijë lekë deri në një milion lekë dhe heqjen e reklamave.

Neni 23

1. Dënimet dhe masat administrative vendosen nga organet përkatëse të Ministrisë së Financave dhe nga inspektorët e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Mënyra e ankimit dhe e ekzekutimit të masës administrative bëhet në përputhje me ligjin

nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Çdo akt ligjor dhe nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 25

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 15, 16, 21 dhe 23 të këtij ligji.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2836, datë 18.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8701, datë 1.12.2000

PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat për mënyrën e zhvillimit të lojërave të fatit, të kazinove dhe të basteve, të cilat vihen për garat e zhvilluara në hipodrome, si dhe licencimin e organizatorit të tyre.

Neni 2
Lojërat e fatit
Përkufizimi

1. Lojëra fati quhen ato lojëra, ku pjesëmarrësit paguajnë një shumë të caktuar dhe ku faktori fat ka ndikim të drejtpërdrejtë si në fitimin, ashtu edhe në humbjen e pjesëmarrësve në secilën lojë.
2. Nuk quhen lojëra fati:
   - Konkurset që zhvillohen në bazë të njohurive të pjesëmarrësve, ku fituesi merr një çmim të caktuar të vendosur për këtë qëllim.
   - Pagesat që bëhen nga sigurimi i jetës ose llojet e tjera të sigurimit nëpërmjet tërheqjes me short të biletave të emetuara për këtë qëllim.

Neni 3
Lojërat e fatit
Kategoritë

Për qëllime të këtij ligji, lojërat e fatit klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

1. Lojërat aritmetike janë ato lojëra, ku pjesëmarrësi shënon sipas zgjedhjes së vet një seri numrash nga një bashkësi e caktuar numrash të shënuara në biletën e lojës. Lojtari fiton kur numrat e zgjedhur prej tij përkojnë me numrat që do të dalin në hedhjen publike të shortit të kësaj loje. Në këtë kategori hyjnë lojërat e mëposhtme:

- Loto: Një lojë fati ku organizatori u ofron pjesëmarrësve në lojë mundësinë e zgjedhjes së disa numrave nga një grup i caktuar numrash, të cilët janë shënuar në biletën e lojës së hedhur në qarkullim. Fitoret përcaktohen nga përputhja e numrave të zgjedhur nga lojtari me grupin e numrave të dalë nga tërheqja e shortit në mënyrë publike.
- Keno: Një lojë fati gjatë së cilës organizatori i ofron pjesëmarrësve mundësinë e zgjedhjes së disa numrave nga një grup i caktuar numrash të shënuar në një biletë të caktuar. Loja Keno përcaktohet me tri numra a/b/c, ku:
  "a" është grupi i numrave të zgjedhur nga lojtari;
  "b" është grupi i numrave të dalë nga hedhja e shortit;
  "c" është grupi i të gjithë numrave të biletës.
- Bingo: Loja ku nga hedhja e shortit dalin aq numra sa nevojiten për të pasur një fitues. Në këtë lojë pjesëmarrësit pajisen me bileta të caktuara, të cilat përmbajnë një grup numrash, pjesë përbërëse të një grupi tjetër të caktuar numrash.
- Proto: Një lojë fati ku organizatori u ofron pjesëmarrësve në lojë mundësinë të zgjedhin një numër me tre deri në nëntë shifra, i cili ose parashikohet nga pjesëmarrësit ose del rastësisht nga një tërheqje në mënyrë publike e shortit.
- Xhoker: Një lojë fati ku organizatori u ofron pjesëmarrësve në lojë mundësinë të zgjedhin drejtpërdrejt disa numra nga një grup i caktuar numrash, që përfshihen në fushën e parë të biletës dhe një ose më tepër numra, që përfshihen në fushën e dytë të së njëjtës biletë ose në fusha të tjera.

2. Lojëra fati sportive janë ato lojëra fati rezultati i të cilave varet nga parashikimi i saktë nga pjesëmarrësit i rezultatit të një gare ose të një ngjarjeje tjetër sportive. Parashikimi i pjesëmarrësve në to shënohet në një biletë të veçantë, të cilën e shpërndan organizatori i lojës.

Në këtë kategori klasifikohen lojërat e mëposhtme:

- Konkurs për parashikimet sportive, për gjetjen e rezultateve të ndeshjeve të futbollit ose të lojërave të tjera sportive, ku pjesëmarrësit në lojë duhet të arrijnë të parashikojnë saktë rezultatet e ndeshjeve që janë shënuar në një biletë të veçantë.
- Basti, ku parashikimi për rezultatin e çdo loje, kolektive ose individuale, si dhe të ngjarjeve, natyra e të cilave jep mundësinë e vendosjes së basteve. Rezultatet e të gjitha basteve janë të përcaktuara ose të ndryshueshme. Të përcaktuara janë ato rezultate që vendosen që më parë nga organizatori dhe u njoftohen lojtarëve para fillimit të basteve. Të ndryshueshme janë ato rezultate që ndryshojnë në varësi të shumave që grumbullohen për alternativat e ndryshme të një ose më shumë lojërave ose ngjarjeve, në bazë të të cilave zhvillohen parashikimet dhe përcaktohen përfundimisht pas skadimit të afatit të dorëzimit të biletave për parashikimin përkatës.

Për qëllime të këtij ligji, parashikimi i ndërsjellë për garat me kuaj me rezultatet e parashikuara ose jo sipas nenit 21 të këtij ligji, përjashtohen kategoritë e lojës sportive të fatit dhe ato zhvillohen sipas nenit 23 të këtij ligji.

3. Llotaritë janë ato lojëra fati ku organizatori i ofron blerësit të tyre mundësinë të fitojnë një shumë të caktuar, nëse fiton numri ose kombinimi i numrave ose i simboleve që shënohen në biletën e hedhur në qarkullim nga organizatori.

Llotaritë klasifikohen në:

- llotari për të cilat hidhet short. Këto janë lojëra fati ku pjesëmarrësi synon të fitojë një shumë të caktuar, nëse në hedhjen e shortit, që bëhet në mënyrë publike, fiton numri që shënohet në biletën që ai ka zgjedhur;

- llotaria e çastit. Këto janë lojëra fati ku blerësit të biletës së llotarisë i ofrohet mundësia që ai ta bëjë vetë fshirjen e shiritit mbulues të numrit të shënuar, brenda intervalit kohor të caktuar, në të cilin është e vlefshme seria e biletës së llotarisë.

4. Lojërat elektronike me fitim në çast janë ato lojëra fati të cilat zhvillohen me ndihmën e kompjutërve elektronikë ose të makinave elektronike, që organizatori i ka vendosur në vende të caktuara dhe që nëpërmjet tyre pjesëmarrësi në lojë, duke vendosur një shumë, mund të fitojë një shumë të caktuar, të cilën e merr ose drejtpërdrejt nga makina ose në një mënyrë tjetër të paracaktuar.

Neni 4

Për shqyrtimin e kërkesave për licencimin dhe mbikëqyrjen e lojërave të fatit, në varësi të Ministrit të Financave, krijohet Komiteti i Lojërave të Fatit. Përgjegjësitë, mënyra e organizimit dhe forma juridike që do të ketë ky Komitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5
Emërimi i personelit

Emërimi i personelit, që do të punësohet në Komitetin e Lojërave të Fatit, bëhet nga Ministri i Financave, i cili miraton edhe numrin e nevojshëm të të punësuarve.

Neni 6
Leja dhe organizatori

1. Ministri i Financave, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, jep leje për organizimin e lojërave të fatit. Leja jepet për një periudhë kohe 10-vjeçare.

Për marrjen e lejes për zhvillimin e lojërave të fatit, të parashikuara në këtë ligj, organizatori paguan një shumë prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për njërën nga lojërat e dhëna, si më poshtë:

- Llotaritë aritmetike
- Llotaritë
- Lojërat sportive të fatit
- Lojërat elektronike

Kriteret për dhënien e lejeve për lojërat e fatit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Organizatori i pajisur me lejen përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji, zhvillon lojërat e fatit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Leje për ushtrimin e veprimtarive për lojëra fati mund të japin edhe organet e qeverisjes vendore, pas miratimit paraprak nga Ministri i Finacave, për personat juridikë, me synimin për të financuar veprimtaritë e tyre bamirëse dhe humanitare. Këto leje jepen vetëm për organizim llotarish dhe duhet të zhvillohen në një vend dhe në kohë të kufizuara dhe të kenë lidhje me një situatë ose ngjarje konkrete. Shpërndarja e të ardhurave për lojërat e parashikuara në këtë paragraf përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Në lejen e dhënë organizatorit duhet të jetë përcaktuar shprehimisht se organizatori është i detyruar të mbulojë vetë shumën e përgjithshme të shpenzimeve që i nevojiten për organizimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e lojërave të fatit që ai do të zhvillojë.

5. Standardet e biletave, që përdoren nga organizatori për zhvillimin e lojërave të fatit, propozohen nga Komiteti i Lojërave të Fatit dhe miratohen me akt të Ministrit të Financave.

6. Ministria e Financave merr masa për shtypjen e përqendruar të biletave sipas skemës së duhur, si dhe për shpërndarjen dhe kontrollin e hedhjes së tyre në përdorim.

Neni 7
Detyrimet e organizatorit

Leja për organizimin dhe funksionimin e lojërave të fatit i jepet vetëm një shoqërie tregtare, e cila plotëson kushtet e mëposhtme:

- Është shoqëri anonime, e pajisur me kapital vendas, të huaj ose të përbashkët dhe me seli

në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Deklaron themeluesit e shoqërisë.
- Deklaron drejtuesit dhe personelin kryesor të shoqërisë.
- Ka një marrëveshje paraprake për të bashkëpunuar me njërën nga bankat me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave.
- Ka teknologjinë e nevojshme për funksionimin e sistemeve mbështetëse të lojërave të fatit, sipas karakteristikave metrologjike të përcaktuara me ligj.
- Ka personel të përgatitur me specializimin përkatës dhe me përvojën e nevojshme për zhvillimin e lojërave të fatit.
- Garanton pagimin e shumave kundrejt fituesve të lojërave të fatit. Mënyra, forma dhe shuma e garancive përcaktohen në lejen që i jepet organizatorit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
- Pranon të dorëzojë për kontroll dhe mbikëqyrje çdo dokumentacion ose të dhënë që i kërkohet nga Komiteti i Lojërave të Fatit.

Neni 8
Revokimi i lejes

Organizatorit të lojës së fatit, të cilit i është dhënë leja, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, mund t'i hiqet leja nga Ministri i Financave, kryesisht ose me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, në rast se ai nuk u përmbahet dispozitave të këtij ligji, si dhe akteve të tjera ligjore, që kanë të bëjnë me zhvillimin e veprimtarisë së tij. Leja i hiqet sidomos në ato raste kur organizatori nuk shlyen rregullisht dhe brenda afateve të përcaktuara detyrimet kundrejt Buxhetit të Shtetit, Komitetit të Lojërave të Fatit, fituesve dhe organeve të kontrollit teknik, si dhe kur nuk bën shpallje zyrtare për përfundimin e hedhjes së shorteve, të cilat duhet të realizohen në prani të komisioneve, ku duhet të marrin pjesë përfaqësues të Komitetit të Lojërave të Fatit.

Neni 9
Tatimi për organizatorin

Fitimet, që organizatori i lojërave të fatit realizon nga ushtrimi i veprimtarisë së tij, janë të tatueshme, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 10
Ndarja e të ardhurave

Tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit i nënshtrohen të gjithë legjislacionit aktual tatimor në fuqi. Përveç kësaj ato paguajnë 20 për qind tatim mbi lojërat e fatit. Ky tatim është pjesë e volumit të qarkullimit gjithsej të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Këshilli i Ministrave përcakton ndarjen e të ardhurave që mbeten pas zbritjes së TVSH-së dhe të tatimit mbi lojërat e fatit, për organizatorin dhe për fituesit.

Neni 11
Përtëritja e lejes

1. Ministri i Financave, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, bën ripërtëritjen e lejeve, për afate pesëvjeçare, me të njëjtat kushte. Pagesa për lejet e ripërtërira, sipas këtij paragrafi, janë sa gjysma e shumës së parashikuar në nenin 6 të këtij ligji.

2. Organizatori i lojës së fatit duhet të bëjë kërkesë, pranë Komitetit të Lojërave të Fatit, për ripërtëritjen e lejes, të paktën 6 muaj përpara mbarimit të afatit të lejes së dhënë.

Neni 12

Komiteti i Lojërave të Fatit ushtron funksion edhe për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve nga Ministri i Financave dhe nga Ministri i Rendit Publik për ushtrim veprimtarie për kazinotë dhe për hipodromet.

Neni 13
Kazino

1. Leja për ushtrim veprimtarie për kazino i jepet organizatorit në bazë të dispozitave të këtij ligji për një periudhë 15-vjeçare.

2. Këshilli i Ministrave, me vendim të veçantë, përcakton zonat se ku mund të hapen kazinotë. Ministri i Financave dhe Ministri i Rendit Publik, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, përcaktojnë numrin e kazinove, që mund të hapen në çdo zonë të përcaktuar sipas këtij neni. Në çdo rast organizatori i pajisur me leje, nuk mund të hapë më shumë se një kazino në zonat e përcaktuara, sipas këtij neni.

3. Detyrimet e organizatorit dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së tij përcaktohen në lejen e dhënë për këtë qëllim.

4. Të gjitha shpenzimet për ngritjen dhe funksionimin e kazinosë janë në ngarkim të organizatorit.

5. Organizatori ka të drejtë që në mjediset e kazinosë të vendosë edhe lojëra elektronike me fitim në çast. Kushtet e vendosjes dhe sasia e tyre përcaktohen në lejen e dhënë. Detyrimi për të ardhurat e realizuara nga këto lojëra është i njëjtë me atë të përcaktuar për organizatorët e tjerë, që kanë si objekt veprimtarie ushtrimin e lojërave elektronike të fatit me fitim në çast.

6. Rregullorja për funksionimin e kazinosë, përsa u përket kushteve që duhen të plotësojnë pjesëmarrësit në lojë, orët e funksionimit të kazinosë, lojërat që do të luhen në të, si dhe organizimi në përgjithësi i kazinosë, miratohet nga Ministri i Financave në çastin e dhënies së lejes.

Neni 14
Personeli i kazinosë

1. Personeli i punësuar në kazino duhet të jetë të paktën mbi moshën 21 vjeç, të ketë zotësi të plotë juridike edhe për të vepruar, si dhe nuk duhet të jetë i dënuar më parë penalisht për vepra penale, të cilat parashikojnë dënim me burgim.

2. Organizatori në bashkëpunim me Komitetin e Lojërave të Fatit dhe me Ministrinë e Rendit Publik përcakton mënyrën e sigurimit të kazinosë dhe të kontrollit të pjesëmarrësve në lojë gjatë hyrjes në sallë.

3. Organizatori, vetë ose në bashkëpunim me organet e rendit të vendit ku është hapur kazinoja, merr masat për ndalimin e futjes në mjediset e kazinosë të personave nën moshën 18 vjeç.

4. Organizatori vë në dispozicion të Komitetit të Lojërave të Fatit dhe të personave të autorizuar nga Ministri i Financave dhe organi i kontrollit teknik çdo lloj dokumentacioni ose çdo të dhëne që kërkohet nga këta të fundit, për të ushtruar kontroll ose për mbikëqyrjen e veprimtarisë.

Neni 15
Organizatori i kazinove

1. Leja për ushtrim veprimtarie për kazino i jepet një shoqërie tregtare, e cila plotëson kushtet e mëposhtme:

- Të jetë shoqëri anonime, me kapital vendas, të huaj ose të përbashkët, si dhe të ketë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Të ketë si objekt të veprimtarisë së saj organizimin e lojërave në kazino.
- Të ketë në organet e saj drejtuese persona të specializuar dhe që zotërojnë njohuri profesionale në fushën e funksionimit të kazinove.
- Kapitali themeltar i shoqërisë të jetë jo më i vogël se sa 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë dhe jo më shumë se 1/10 e tij të jetë në natyrë.

- Të garantojë në çdo çast pagimin e shumave të pjesëmarrësve në lojërat e kazinosë.
- Të deklarojë themeluesit e shoqërisë.
- Të deklarojë drejtuesit dhe personelin kryesor të shoqërisë.

2. Mënyra, forma, kriteret specifike për zgjedhjen e organizatorit, si dhe masa dhe kushtet e garancisë, të parashikuara në pikën 1 paragrafi 5 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16
Revokimi i lejes

Ministri i Financave, kryesisht ose me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, mund të revokojë lejen e dhënë për kazino kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji, të kushteve të përcaktuara në leje, si dhe të akteve të tjera ligjore, që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së subjektit dhe, sidomos, kur nuk shlyen rregullisht dhe brenda afateve të përcaktuara detyrimet kundrejt buxhetit të shtetit, Komitetit të Lojërave të Fatit dhe fituesve.

Neni 17

1. Nëse lojërat e fatit, që zhvillohen në kazino, bien në kundërshtim ose cenojnë interesin e përgjithshëm, Ministria e Financave, kryesisht ose me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, anulon lejen për zhvillimin e tyre ose ndërpret pa paralajmërim procedurat për dhënien e lejes.

2. Rastet kur cenohet interesi i përgjithshëm, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, janë:

- mashtrimi i publikut;
- pastrimi i parave;
- cenimi i rendit publik dhe nxitja e kriminalitetit.

Neni 18

Organizatorit i jepet leje për zhvillimin e lojërave në kazino, kur ai, përveç kushteve të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji, plotëson edhe kushtet e mëposhtme:

- Lojërat të zhvillohen në salla të caktuara paraprakisht për këtë qëllim.
- Përdor pajisje të standardeve të njohura bashkëkohore, sipas karakteristikave teknike të përcaktuara me ligj për të gjitha llojet e lojërave.
- Punëson personel të përshtatshëm që zotëron njohuri profesionale në këtë fushë.
- Ka miratimin e Ministrisë së Rendit Publik për mbrojtjen e mjedisve, brenda dhe jashtë sallës ku do të zhvillohen lojërat.

Neni 19

Organizatorit i jepet leje për zhvillimin e lojërave në kazino vetëm pasi ai ka paguar shumën prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh për secilën kazino, shumë e cila paguhet vetëm njëherë, me marrjen e lejes.

Neni 20

Organizatori i lojës së kazinosë nuk mund të krijojë degë ose filiale të shoqërisë brenda ose jashtë vendit pa miratimin e Ministrit të Financave. Për marrjen e miratimit ai duhet të paraqesë paraprakisht kërkesë pranë Komitetit të Lojërave të Fatit, i cili e shqyrton dhe ia paraqet për miratim Ministrit të Financave.

Neni 21
Rregulloret e lojërave në kazino

1. Organizatori përgatit për secilën lojë, që do të luhet në kazino, rregulloren e saj. Ai e bën të

njohur këtë rregullore, në mënyrë që pjesëmarrësit në lojëra njihen me të.

2. Rregulloret e lojërave përfshijnë kryesisht:

- Rregullat për mënyrën e pjesëmarrjes në lojë dhe përcaktimin e maksimumit dhe të minimumit të shumës, që paguhet për çdo lojë.
- Kushtet për lejimin e hyrjes së personave në kazino.
- Orën e hapjes dhe të mbylljes së kazinosë.

3. Miratimi i rregulloreve bëhet nga Ministri i Financave me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, pas shqyrtimit të projekteve të paraqitura nga organizatori.

Neni 22

Ndarja e të ardhurave

Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit, i nënshtrohen të gjithë legjislacionit aktual tatimor në fuqi. Përveç kësaj ato paguajnë 20 për qind tatim mbi lojërat e fatit. Ky tatim është pjesë e volumit të qarkullimit gjithsej të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Këshilli i Ministrave përcakton ndarjen e të ardhurave që mbeten pas zbritjes së TVSH-së dhe të tatimit mbi lojërat e fatit, për organizatorin dhe për fituesit.

Neni 23

Hipodromi

1. Organizatorit, i cili kërkon të ushtrojë veprimtarinë në fushën e lojës për garat sportive që zhvillohen në hipodrom, leja i jepet për një periudhë 15-vjeçare nga organet e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

2. Organizatori, i cili merr lejen për vendosjen e basteve për garat me kuaj ose për garat e tjera në hipodrom, që më poshtë do të quhen "gara", paguan një shumë në favor të shtetit në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, e cila paguhet vetëm njëherë, me marrjen e lejes.

3. Organizatorit të pajisur me leje për lojërat e fatit, që zhvillohen për shkak të garave që bëhen në hipodrom, i jepet e drejta për ndërtimin e një stadiumi për garat. Lejet përkatëse për kryerjen e ndërtimit merren nga vetë organizatori, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në rast mosmiratimi të lejes për ndërtimin e hipodromit, brenda një periudhe 1-vjeçare nga data e marrjes së lejes për zhvillimin e lojës, organizatorit i hiqet leja e dhënë për këtë qëllim, si dhe i jepet e drejta për t'iu kthyer shuma e paguar prej tij, sipas paragrafit 2 të këtij neni, vetëm për ato raste kur refuzimi është bërë për shkaqe që nuk varen prej organizatorit.

4. Kushtet specifike të funksionimit të hipodromit, kushtet e pjesëmarrjes së lojtarëve, orët e zhvillimit të garave për çdo javë, llojet e basteve që do të vihen, si dhe shumat e basteve për çdo lojë përcaktohen në rregulloren e lojës, e cila miratohet nga Ministri i Financave në çastin e dhënies së lejes.

5. Hyrja në hipodrom lejohet edhe për personat nën 18 vjeç, me kusht që të jenë të shoqëruar nga prindërit ose kujdestarët ligjorë të tyre.

6. Organizatori ka të drejtë që në mjediset e hipodromit të vendosë edhe lojëra elektronike me fitim në çast. Kushtet e vendosjes dhe sasia e tyre përcaktohen në lejen e dhënë. Detyrimi për të ardhurat e realizuara nga këto lojëra është i njëjtë me atë të përcaktuar për organizatorët e tjerë, që kanë si objekt veprimtarie ushtrimin e lojërave elektronike të fatit me fitim në çast. Organizatorit i jepet e drejta së bashku me lejen, të zhvillojë lojëra fati për parashikimet për garat që kryhen në hipodrom, si dhe në pika shitjeje, jashtë hipodromit.

7. Organizatori duhet të informojë pjesëmarrësit në lojë, nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë të garave, me mjetet elektronike informimi, si dhe t'i bëjë publike rezultatet e garave në po këto mjete, në gazeta me qarkullim në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat e shitjes ose në pika të tjera, që ai mund të ketë ngritur për informimin e pjesëmarrësve në lojë.

Neni 24

1. Leja për ushtrimin e veprimtarisë për zhvillimin e basteve për garat në hipodrom i jepet një shoqërie tregtare që plotëson kushtet e mëposhtme:

- Të jetë shoqëri anonime, e pajisur me kapital vendas, të huaj ose të përbashkët, si dhe të ketë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Të ketë si objekt të veprimtarisë së saj funksionimin dhe mbështetjen e basteve që zhvillohen për garat në hipodrom.
- Të ketë në organet drejtuese të saj persona të specializuar dhe që zotërojnë njohuri profesionale në fushën e zhvillimit të basteve për garat me kuaj.
- Kapitali themeltar i shoqërisë të jetë jo më i vogël se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë dhe jo më shumë se 1/10 e tij të jetë në natyrë.
- Të garantojë në çdo çast pagimin e shumave të pjesëmarrësve në bastet që ata vënë për zhvillimin e garave në hipodrom.
- Të deklarojë themeluesit e shoqërisë.
- Të deklarojë drejtuesit dhe personelin kryesor të shoqërisë.

2. Mënyra, forma, kriteret për zgjedhjen e organizatorit, si dhe masat e kushtet e garancisë, të parashikuara në paragrafin 1 pika 5 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25
Ndarja e të ardhurave

Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojrave të fatit, i nënshtrohen të gjithë legjislacionit aktual tatimor në fuqi. Përveç kësaj, ato paguajnë 20 për qind tatim mbi lojërat e fatit. Ky tatim është pjesë e volumit të qarkullimit gjithsej të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Këshilli i Ministrave përcakton ndarjen e të ardhurave që mbeten pas zbritjes së TVSH-së dhe të tatimit mbi lojërat e fatit, për organizatorin dhe për fituesit.

Neni 26
Revokimi i lejes

Ministri i Financave kryesisht ose me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, mund të revokojë lejen e dhënë për kazino kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji, kushteve të përcaktuara në leje, si dhe të akteve të tjera ligjore, që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së subjektit dhe, sidomos, kur nuk shlyen rregullisht dhe brenda afateve të përcaktuara detyrimet kundrejt Buxhetit të Shtetit, Komitetit të Lojërave të Fatit dhe të fituesve.

Neni 27
Sanksionet

Ushtrimi i veprimtarive, të cilat janë rregulluar me këtë ligj, pa lejen e organeve përkatëse, dënohet me gjobë si më poshtë:

- për llotaritë aritmetike 40 000 000 lekë
- për llotaritë 40 000 000 lekë
- për lojërat sportive të fatit 40 000 000 lekë
- për makinat elektronike 500 000 lekë (për çdo makinë)
- për kazinotë 40 000 000 lekë
- për bastet 40 000 000 lekë
- për bastet e garave në hipodrom 60 000 000 lekë

2. Shkelja e dispozitave të këtij ligji nga organizatori i lojërave të fatit, kazinove dhe i lojërave të hipodromit, nëse nuk përbën vepër penale, vlerësohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Ankimi për sanksionet e marra kundrejt personave, sipas këtij neni, bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 28

1. Hedhjet e shortit për secilën lojë bëhen në transmetim të drejtpërdrejtë nga organizatori

nëpërmjet mjeteve elektronike të informimit, që mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për ato lojëra fati, të parashikuara në këtë ligj, ku personi merr pjesë në lojë me blerjen e biletës dhe kur loja nuk zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallave ose për ato lojëra, ku fitimi i jepet në çast.

2. Organizatori informon pjesëmarrësit në lojë për çdo përfundim të lojës dhe shpall fituesit e çdo kategorie nëpërmjet mjeteve të informimit, me mbulim dhe qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Shpenzimet për publikimet e bëra, sipas përcaktimit në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përballohen nga organizatori.

Neni 29

Dispozita përfundimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve në zbatim të neneve 4, 10, 13, 15, 22, 24 e 25 të këtij ligji.

Neni 30

Ripërtëritja vjetore e lejeve për licencat ekzistuese, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, bëhet sipas kritereve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 31

Ligji nr.7871, datë 9.11.1994 "Për lojërat e fatit dhe kazinotë", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 32

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2843, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8704, datë 1.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT (NË BAZË TË TERMAVE TË REFERENCËS SË "KLUBIT TË PARISIT")"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për konsolidimin e borxhit (në bazë të termave të referencës së "Klubit të Parisit")".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2844, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

TERMAT E REFERENCËS
LIDHUR ME KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I) HYRJE

Përfaqësuesit e Qeverive të Gjermanisë, Austrisë, Francës, Italisë, Japonisë, Hollandës dhe të Federatës Ruse, të quajtura më poshtë "vendet pjesëmarrëse kreditore", kanë vendosur t'i akordojnë Republikës së Shqipërisë një lehtësim të shërbimit të borxhit të jashtëm të këtij vendi, në formën e një diferencimi pagesash.

Përfaqësuesit e Qeverive të vendeve pjesëmarrëse kreditore janë njoftuar mbi masat e rëndësishme që janë marrë në fushat ekohnomike dhe financiare në kuadrin e programit të rregullimit të zbatuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, mbështetur në marrëveshjen për Mbështetjen e Reformave Strukturore me Fondin Monetar Ndërkombëtar e miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit më 13 Maj 1998 dhe që mbulon periudhën deri më 12 Maj 2001. Kjo marrëveshje përmban angazhime të sakta në fushat ekonomike dhe financiare.

Përfaqësuesit e këtyre vendeve kanë theksuar rëndësinë që ata i kushtojnë përmbushjes së rregullt dhe të plotë të kësaj marrëveshjeje dhe, në mënyrë të veçantë, rigjallërimit të sektorit prodhues dhe përmirësimit të drejtimit të financave shtetërore dhe të përdorimit të rezervave valutore.

Ata janë njohur me problemet shumë të rënda të bilancit të pagesave dhe me borxhin e madh të Republikës së Shqipërisë, si edhe me nivelin e ulët të të ardhurave për banor, dhe janë të mendimit që të gjitha këto meritojnë një trajtim të veçantë të borxhit, duke patur parasysh programin e rëndësishëm të rregullimit të theksuar me sipër.

II) REKOMANDIME LIDHUR ME TERMAT E REFERENCËS:

Duke marrë parasysh vështirësitë serioze të pagesave që has Republika e Shqipërisë, përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse kreditore ranë dakord t'u rekomandojnë Qeverive të tyre ose organizmave përkatëse, një lehtësim të borxhit të Republikës së Shqipërisë me anë të një shtyrjeje (riogranizimi), sipas termave të mëposhtme:

1) Përcaktimi i borxheve për të cilat bëhet fjalë.

Borxhet për të cilat do të zbatohet ky riorganizim janë:

a) kreditë tregtare, që kanë patur në fillim një afat të kredisë mbi një vit, të garantuara ose të siguruara nga Qeveritë ose organizmat përkatëse të vendeve pjesëmarrëse kreditore, të akorduara Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose organizmave përkatëse të saj, ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose institucionet e saj përkatëse, dhe që janë objekt i një kontratë të përfunduar përpara 30 Shtatorit 1993;

b) huatë qeveritare ose të organizmave përkatëse të vendeve pjesëmarrëse kreditorë, që kanë që në fillim një zgjatje të kredisë mbi një vit, të akorduara Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose organizmave të saj përkatëse, ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga institucionet e saj përkatëse, dhe që janë objekt i një kontrate të përfunduar përpara 30 Shtatorit 1993;

c) shlyerjet e principalit dhe të interesave që rezultojnë nga marrëveshjet e konsolidimit të përfunduara ose për t'u përfunduar në zbatim të Nenit I të Termave të Referencës të 15 Dhjetorit 1993;

d) shlyerjet e principalit dhe të interesave që rezultojnë nga marrëveshjet e konsolidimit të

përfunduara ose për t'u përfunduar në zbatim të Nenit II, paragrafet 1 dhe 2 të Termavetë Referencës së 22 Korrikut 1998;

e) huatë dhe kreditë, që kanë fillimisht një kohëzgjatje mbi një vit dhe që jaë objekt i një kontrate ose i çdo formë tjetër marrëveshjeje financiare e përfunduar midis 30 Shtatorit 1993 dhe 1 Prillit 1999;

f) kreditë tregëtare që kanë fillimisht një kohëzgjatje më të vogël ose të barabartë me një vit, të përfunduara përpara 1 Prillit 1999.

Në këtë riorganizim, përfshihet shërbimi i borxhit, në kuptimin e borxheve të përshkruara më sipër në këto Terma Reference dhe i kryer nëpërmjet mekanizmave speciale të pagesës ose llogarive të tjera të jashtme. Vendet pjesëmarrëse kreditore do të ricaktojnë, do të rifinancojnë ose do të marrin masa të tjera të përshtatshme me qëllim që të sigurojnë që kjo kategori e borxheve të trajtohet sipas termave të krahasueshme me ato të zbatuara për borxhe të tjera që përfshihen në këto Terma Reference.

Kuptohet që shërbimi i borxhit për huatë dhe kreditë e përfshira në paragrafet 1.e) dhe 1.f) në asnjë rast nuk do të preket me një trajtim përfundimtar.

1) Kushtet e reja të shlyerjes

Lehtësimi i borxhit do të bëhet sipas mënyrës së mëposhtme:

a) 100% e shumave të principalit dhe të interesave (duke përfshirë edhe interes vonesat) që duheshin paguar më 31 Mars 1999 dhe që nuk janë paguar dhe 100% e shumave të principalit dhe interesave (duke përjashtuar interes vonesat) që duhen paguar në periudhën ndërmjet 1 Prillit 1999 dhe 30 Qershorit 2000 (duke përfshirë edhe këtë datë) dhe që nuk janë paguar për kredit edhe huatë e cituara në paragrafet 1.a), 1.b), 1.c), 1.d), 1.e) dhe 1.f) këtu më sipër, do të ricaktohen ose rifinancohen. Kthimi i shumave përkatëse nga ana e Qeverisë së Republikës do të kryhet në 10 këste të barabarta dhe të njëpasnjëshme gjashtëmujore, kësti i parë do të paguhet më 30 Qershor 2001 dhe i fundit më 31 dhjetor 2005;

b) përqindjet dhe kushtet e interesit për marrëveshjet e ricaktimit ose të rifinancimit që mbulohen nga paragrafi a) më sipër dhe nga paragrafi c) më poshtë, do të përcaktohen në baza dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë ose institucionit përkatës të secilit prej vendeve pjesëmarrëse kreditore, mbi bazën e përqindjes përkatëse të tregut. Përsa i përket Huave të Ndihmës Shtetërore për Zhvillim, përqindjet dhe kushtet e interesit do të jenë të paktën po aq favorizuese sa edhe përqindjet koncensionale që zbatohen aktualisht për këto hua.

Interes vonesat janë interesa që zbatohen për periudhën midis datës së fiksuar në kontratë për pagesën e principalit dhe të interesave që duhen paguar dhe që nuk janë paguar, dhe një datë që do të fiksohet në marrëveshjet dypalëshe që do të nënshkruhen në zbatim të këtyre Termave të Referencës;

c) 100% e interesave të parashikuara ndërmjet 1 prillit 1999 dhe 30 Qershorit 2000 (duke përfshirë edhe këtë datë), për shumat e konsoliduara dhe të theksuara në paragrafin a) këtu më sipër, do të kapitalizohen më 30 Qershor 2000 dhe do të paguhen në 10 këste të barabarta dhe të njëpasnjëshme gjashtëmujore, i pari me 30 Qershor 2001 dhe i fundit më 31 Dhjetor 2005.

III) REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

1. Me qëllim që të sigurojë një trajtim të barabartë të borxhit të saj kundrejt të gjithë kreditorëve publikë ose privatë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të negociojë në afatet më të përshtatshme me të gjithë kreditorët e saj të jashtëm, marrëveshje të riadministrimit të borxhit me terma të krahasueshme me ato të parashikuara nga këto Terma Reference.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet që të mos i akordojë asnjë kategorie të kreditorëve të jashtëm - dhe në mënyrë të veçantë vendeve kreditore që nuk marrin pjesë në këto Terma Reference, bankave tregtare dhe furnitorëve një trajtim më të favorshëm se ai i akorduar vendeve pjesëmarrëse kreditore për kreditë me kohëzgjatje dhe natyrë juridike të ngjashme.

Me qëllim që të krahasohen marrëveshjet e përfunduara ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me kreditorët e saj që nuk janë pjesëmarrës në këto Terma Reference, nga njëra anë, dhe marrëveshjet e përfunduara me vendet pjesëmarrëse kreditore nga ana tjetër, do të merren në konsideratë të gjitha elementet domethënëse, ndërmjet të cilave: rreziku real i vendeve kreditore që nuk marrin pjesë në këto Terma Reference; niveli i pagesave në para që janë kryer në favor të këtyre vendeve nga ana e Republikës së Shqipërisë në raport me peshën e tyre në borxhin e jashtëm të

Republikës së Shqipërisë; natyra dhe tiparet e çdo varianti të paraqitur, duke përfshirë edhe blerjen e borxhit, si edhe të gjitha karakteristikat e pretendimeve të ribiseduara dhe në mënyrë të veçantë termat e pagesës (kthimit të borxhit) të çfarëdo forme dhe në përgjithësi, lidhjet financiare midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe vendeve kreditore që nuk marrin pjesë në këto Terma Reference.

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të njoftojë me shkrim Presidentin e Klubit të Parisit, jo më vonë se 31 Mars 2000 mbi gjendjen e bisedimeve të saj dhe me përmbajtjen e marrëveshjeve dypalëshe që ajo ka arritur me kreditorët e tjerë.

Përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të njoftojë rregullisht me shkrim Presidentin e Klubit të Parisit për gjendjen e bisedimeve me kreditorët e tjerë dhe për pagesat e kryera në favor të tyre.

2. Dispozitat e ketyre Termave të Referencës nuk zbatohen për ato vende kreditore për të cilat shuma e përgjithshme e kësteve të principalit dhe interesit që duhen paguar gjatë periudhës së riorganizimit në kuptimin e borxheve të specifikuara në Nenin II, paragrafi 2, është më e vogël se 150,000 SDR.

Pagesat për këto vende duhen kryer më 30 Qershor 2001. Interesat e pashlyera për këto shuma do të llogariten dhe kapializohen më 30 Qershor 2000.

3. Vendet pjesëmarrëse kreditore kanë rënë dakord që secili prej tyre do t'i japë, me kërkesën e çdo vendi tjetër pjesëmarrës kreditor, një kopje të marrëveshjes së saj dypalëshe me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë në zbatim të këtyre Termave të Referencës. Qeveria e Republikës së Shqipërisë është në dijeni të kësaj dispozite.

4. Secili prej vendeve pjesëmarrëse kreditore pranon të njoftojë Presidentin e Klubit të Parisit për datën e nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse dypalëshe, për përqindjet e interesit që janë zbatuar si edhe për shumat e borxhit që kanë të bëjnë me secilën prej marrëveshjeve. Qeveria e Republikës së Shqipëris është në dijeni të kësaj dispozite.

5. Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të paguajë të gjitha këstet që duhen paguar dhe që nuk janë paguar deri në datën e këtyre Termave të Referencës në lidhje me konsolidimin e huave, kredive ose të gjitha formave të tjera të rregullimit financiar të pagueshme me para, të akorduara ose të garantuara nga Qeveritë ose organizmat përkatëse të vendeve pjesëmarrëse kreditore, dhe që nuk bëjnë pjesë në fushën e zbatimit të këtyre Termave të Referencës, dhe kjo sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se 31 Dhjetor 1999.

Për këto shuma do të zbatohen interes vonesa.

IV) ZBATIMI

Mënyrat e ricaktimit ose të rifinancimit do të fiksohen në marrëveshjet dypalëshe që do të nënshkruhen nga Qeveritë ose organizmat përkatëse të secilit prej vendeve pjesëmarrëse kreditore me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e parimeve të mëposhtme:

1) Qeveria ose institucionet përkatëse të çdo vendi pjesëmarrës kreditor:

- Ose do të rifinancojë borxhet, duke vënë në dispozicion të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë financime të reja në përputhje me këstet ekzistuese të pagesës gjatë periudhës së konsolidimit dhe për përqindjet e treguara më lart. Këto financime do të kthehen (paguhen) nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në përputhje me këstet e treguara në Nenin II.2, më sipër;
- Ose do të ricaktojë këstet përkatëse.

2) Të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me ricaktimin ose rifinancimin do të fiksohen në marrëveshjet dypalëshe që Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveritë ose organizmat përkatëse të vendeve pjesëmarrëse kreditore do të përpiqen të përfundojnë në afate sa më të përshtatshme, dhe në çdo rast, përpara 31 Mars 2000.

3) Dispozitat e këtyre Termave të Referencës do të vazhdojnë të zbatohen me kusht që Qeveria e Republikës së Shqipërisë vazhdon të ketë një marrëveshje përkatëse me FMN-në dhe që ajo të ketë kryer në kohën e duhur pagesat e parashikuara nga këto Terma Reference.

Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Shqipërisë është dakord që FMN-ja të njoftojë me shkrim Presidentin e Klubit të Parisit mbi gjendjen e marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe FMN-së.

4) Përfaqësuesit e Qeverive të vendeve pjesëmarrëse kreditore dhe përfaqësuesit e Qeverisë së

Republikës së Shqipërisë kanë rënë darkod t'u rekomandojnë Qeverive ose organizmave të tyre përkatëse që të fillojnë sa më shpejt bisedimet dypalashe dhe t'i zhvillojnë ato mbi bazën e parimeve të theksuara më sipër.

L I G J
Nr.8708, datë 1.12.2000

PËR DISA PËRJASHTIME DHE PËR DHËNIEN E DISA STIMUJVE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË KALIVAÇIT ME KONCENSION TË FORMËS "BOT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Periudha e koncensionit në marrëveshjen e koncensionit të formës "BOT" të Hidrocentralit të Kalivaçit, është 30 vjet nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit.

Neni 2

Asnjë akt ligjor, i dalë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së koncensionit, nuk mund të cenojë këtë marrëveshje.

Neni 3

Shoqëria koncensionare e Hidrocentralit të Kalivaçit, sipas nenit 31 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", taksohet me vlerë të TVSH-së në masën zero për qind për mallrat dhe shërbimet e eksportit, gjatë gjithë periudhës së koncensionit.

Organet tatimore bëjnë rimbursimin e tepricës kreditore të TVSH-së brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 4

Shoqëria koncensionare e Hidrocentralit të Kalivaçit përjashtohet nga detyrimet e importit dhe çdo lloj takse, që ka të bëjë me importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve, si për periudhën e ndërtimit edhe për periudhën e koncensionit.

Neni 5

Shoqëria koncensionare e Hidrocentralit të Kalivaçit përjashtohet nga detyrimi i tatimit mbi fitimin për dy vitet e para të shfrytëzimit dhe, për periudhën tjetër të koncensionit, detyrimi i tatimit mbi fitimin të jetë në masën 15 për qind.

Neni 6

Në rastet e shpronësimit ose konfiskimit të impiantit, nga autoritetet shqiptare do të zbatohen dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2845, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8709, datë 6.12.2000

PËR MIRATIMIN E "KONTRATËS PËR SHITJEN E ASETEVE TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS, FUSHË KRUJË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet "Kontrata për shitjen e aseteve të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos, Fushë-Krujë", lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe "Fushë-Kruja Cement Factory" sh.p.k. (e zotëruar tërësisht nga "RMC-ECF Consortium Holding" SAL), i klasifikuar i pari në tenderin e hapur ndërkombëtar për shitjen e Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos, Fushë-Krujë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2846, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONTRATË
PËR SHITJEN E ASETEVE TË
NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS
FUSHË-KRUJË

Në Tiranë, sot më datë 22 shtator 2000 përpara meje noteres Mimoza Shehu u paraqitën palët e mëposhtme:

- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar bashkarisht nga Mustafa Muçi, Ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, dhe znj. Kozeta Fino, Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të Republikës së Shqipërisë, të cilët veprojnë në funksion të detyrës së tyre dhe në emër të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos në Fushë-Krujë, persona madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, të njohur personalisht prej meje (më poshtë bashkërisht të quajtur "Shitësi").

Pala e parë

Dhe

- "Fushë-Kruja Cement Factory" Shpk., një shoqëri e krijuar (e zotëruar tërësisht nga "RMC-ECF Consortium Holding" SAL dhe që në këtë Kontratë vepron në cilësinë e

përfaqësuesit ligjor të këtij të fundit) në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, me nr. 24373, përfaqësuar nga z. Charles Bouri, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje (më poshtë i quajtur "Blerësi").

Pala e dytë

Të cilët kërkuan prej meje redaktimin e kësaj kontrate ("Kontrata") me kushtet e mëposhtme:

MEQENËSE:

A. Në bazë të:

- Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- Ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 31.08.1999 "Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore";
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 09.09.1999 "Për privatizimin e Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë nëpërmjet tenderit", ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 65, datë 24.02.2000;
- Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr. 176, datë 20.05.2000;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 27.07.2000 "Për miratimin e privatizimit të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë", bashkëngjitur kësaj Kontrate si Aneksi A:
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 494, datë 19 shtator 2000.

Shitësi është ligjërisht i autorizuar dhe ka kompetenca të plota për të disponuar asetet e Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë, të cilat përbëhen nga:

(a) Toka. Parcelat e tokave të cilat më hollësisht janë përshkruar në gentplanet dhe në certifikatat e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Zyrës respektive të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bashkëngjitur si Aneks B;

(b) Ndërtesat. Ndërtesat e ndodhura në territorin e Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë dhe kudoqoftë, të përshkruara më hollësisht në certifikatat e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Zyrës respektive të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bashkëngjitur kësaj Kontrate si Aneks C;

(c) Inventaret. Të gjitha pajisjet e lëvizshme dhe të fiksuara, mjetet e transportit, makineritë, pjesët e këmbimit, instrumentet, lëndët e para, produktet e gatshme dhe gjysmë të gatshme etj., të përshkruara më hollësisht në listën e inventareve në Aneksin D bashkëngjitur kësaj Kontrate: (Toka, Ndërtesat dhe Inventaret në këtë kontratë quhen bashkërisht "Pasuria").

B. Blerësi është një shoqëri e krijuar dhe regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe më kërkesat e tenderit të organizuar më 3 korrik 2000, kapitali i së cilës zotërohet tërësisht nga RMC – ECF Consortium SAL dhe paraqitet e vepron në këtë Kontratë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të këtij të fundit.

C. Më 3 korrik 2000, Shitësi hapi tenderin ("Tenderi") për shitjen e Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë;

D. Blerësi është përzgjedhur e shpallur nga Shitësi dhe miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 27.07.2000, fitues i tenderit të organizuar nga Shitësi më 3 korrik 2000.

Kjo Kontratë përcakton kushtet dhe afatet me të cilat Shitësi do të shesë dhe Blerësi do të blejë, Pasurinë objekt i kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Duke marrë parasysh sa më sipër dhe marrëveshjet e dyanshme të përcaktuara këtu më poshtë, palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1
Objekt i Shitjes dhe Blerjes

a. Shitësi nëpërmjet kësaj Kontrate i shet dhe i transferon Blerësit, dhe Blerësi nëpërmjet kësaj Kontrate blen nga Shitësi, Pasurinë e cila përbëhet nga:

- Toka. Parcelat e tokave të cilat më hollësisht janë përshkruar në gentplanet dhe në certifikatat e regjistrimit në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, pranë Zyrës respektive të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, bashkëngjitur si Aneks
- Ndërtesat. Ndërtesat e ndodhura në territorin e Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos

Fushë-Krujë dhe kushdo qoftë tjetër, të përshkruara më hollësisht në certifikatat e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Zyrës respektive të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bashkëngjitur kësaj Kontrate si Aneks C.

- Inventaret. Të gjitha pajisjet e lëvizshme dhe të fiksuara, mjetet e transportit, makineritë, pjesët e këmbimit, instrumentet, lëndët e para, produktet e gatshme dhe gjysmë të gatshme etj., të përshkruara më hollësisht në listën e inventarëve në Aneksin D, bashkëngjitur kësaj Kontrate.

b.Shitja përfshin të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e Shitësit mbi të gjitha servitutet, servitutet e kalimit, privilegj dhe çdo të drejtë tjetër mbi pasurinë.

Neni 2
Çmimi i blerjes dhe mënyra e pagesës

Çmimi i blerjes ("Çmimi i Blerjes") që blerësi i paguan Shitësit për shitjen e Pasurisë dhe të drejtave të përmendura në paragrafin b, të nenit 1 më sipër, është shuma prej 1.750.000.000 (një miliard e shtatëqind e pesëdhjetë milionë) Lekë. Kjo shumë është objekt i rregullimeve të mëposhtme dhe do të paguhet si vijon:

a. Shuma Lekë 280.716.491 (dyqind e tetëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) është paguar nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit më datë 30 qershor 2000, siç vërtetohet nga dokumenti i transfertës bankare bashkëngjitur kësaj Kontrate si Aneks E;

b. Shuma 1.469.283.509 (një miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntë) Lekë do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate.

c. Inventari i pajisjeve të lëvizshme dhe të fiksuara, mjeteve të transportit, makinerive, pjesëve të këmbimit, instrumenteve, lëndëve të para, produkteve të gatshme dhe gjysmë të gatshme etj. (Aneksi D bashkëngjitur) do të verifikohet brenda 15 ditëve nga Dita e Nënshkrimit të Kontratës, sipas afatit të përcaktuar në nenin 3 më poshtë, nga një komision i përbërë nga përfaqësues të caktuar nga Shitësi dhe Blerësi, të cilët do të hartojnë dhe nënshkruajnë një procesverbal me konkluzionet e tyre. Vlera e çdo objekti që mungon do të rikthehet menjëherë me nënshkrimin e procesverbalit të mësipërm nga Shitësi në favor të Blerësit.

Neni 3
Data e Nënshkrimit të Kontratës

Përveç çdo veprimi që do të ndërmerrret dhe çdo instrumenti që do të nënshkruhet dhe/ose paraqitet në përputhje më këtë Kontratë, jo më vonë se data e nënshkrimit të kësaj Kontrate ("Data e Nënshkrimit të Kontratës"):

a. Shitësi do të:

i. Paraqesë certifikatat e pronësisë mbi Pasurinë, konkretisht mbi Tokën dhe Ndërtesat, të regjistruara në pronësi në emër të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë, në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Zyrës(ave) së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kompetente (Anekset B dhe C).

ii. Paraqesë Blerësit Listën e Inventareve e cila përfshin të gjitha pajisjet e lëvizshme dhe të fiksuara, mjetet e transportit, makineritë, pjesët e këmbimit, instrumentet, lëndët e para, produktet e gatshme dhe gjysmë të gatshme etj. të përshkruara më hollësisht në listën e inventarëve në Aneksin D bashkëngjitur kësaj Kontrate:

iii. Paraqesë Blerësit deklarata të lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Autoritetet Tatimore, KESH-i, Ndërmarrja e Ujësjellësit, Rezervat e Shtetit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Administrata Doganore, Enti i Banesave, furnizuesi ARMO Sh.A., nëpërmjet të cilave të vërtetojnë se ata nuk kanë asnjë kërkesë dhe se nuk do të ngrenë asnjë pretendim ndaj blerësit në lidhje me periudhën deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës, duke theksuar faktin që këto institucione/persona juridikë janë në dijeni se këto deklarata lëshohen për shitjen e Pasurisë dhe i nevojiten Blerësit;

iv. Nënshkruajë dhe të paraqesë dhe/ose të sjellë nënshkrimin apo paraqitjen e instrumenteve që në bazë të legjislacionit shqiptar mund të jenë të nevojshëm për t'i transferuar Blerësit me titull të plotë, të pastër dhe të tregtueshëm, pronësinë mbi pasurinë dhe për t'i mundësuar Blerësit arritjen e

qëllimit të kësaj Kontrate:

v.Paraqesë Blerësit çdo dokument të nevojshëm të lëshuar nga Sindikata e Punonjësve që vërteton dorëheqjen e organeve drejtuese dhe punonjësve të mëparshëm të shoqërisë dhe/ose të ndërmarrjes së mëparshme:

vi. Merr përsipër dhe garanton se të bëjë efektive, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kësaj kontrate, pagesën e rrogave dhe dëmshpërblimin për largimin nga puna të të gjithë punonjësve të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë deri në datën e nënshkrimit të Kontratës, së bashku me kontributetet e Sigurimeve Shoqërore përkatëse dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, duke përfshirë çdo penalitet në lidhje me to.

Dhe

b. Blerësi do të paguajë Çmimin e Blerjes, në shumën dhe mënyrën e përshkruar në nenin 2 të kësaj Kontrate:

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Blerësi do të fitojë titullin e pronësisë mbi Pasurinë dhe të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me të, që nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Neni 4
Shkeljet

Të gjitha shkeljet e ligjit, vendimeve të Këshillit të Ministrave ose vendimeve të ndonjë organi lokal, urdhrave, kërkesave ose rregulloreve të cilësuara ose të nxjerra nga autoritetet kompetente që operojnë në sektorin e ndërtimit, zjarrit, punës, shëndetit ose organe, agjenci ose autoritete të tjera lokale dhe/ose qendrore kompetente, shkelje të cilat drejtohen kundër Pasurisë ose që ndikojnë mbi të deri në Datën e Shkrimit të Kontratës dhe çdo urdhër ose kërkesë e mëparshme nga ndonjë shoqëri kundrejt Pasurisë se siguria nga ndonjë humbje e rstit, do të vihet në vend dhe plotësohet nga Shitësi me shpenzimet e veta përpara datës së nënshkrimit të Kontratës. Sidoqoftë Shitësi do të mbetet përgjegjës pas datës së nënshkrimit të Kontratës për çdo shkelje të përmendur më sipër të kryer përpara Datës së Nënshkrimit të Kontratës dhe të zbuluar pas kësaj date.

Neni 5
Garancitë dhe Përfaqësimet e Përgjithshme të Shitësit

Shitësi deklaron, garanton dhe është dakord që:

a. (i) Shitësi është një institucion i organizuar dhe që zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit shqiptar; (ii) Shitësi është ligjërisht i autorizuar dhe ka kompetenca të plota për të shitur Pasurinë dhe për të bërë transferimin e pronësisë mbi të, si dhe të nënshkruajë dokumentet e nevojshme për këtë qëllim; dhe kjo Kontratë është një detyrim i vlefshëm i detyrueshëm dhe i zbatueshëm për Shitësin në përputhje me kushtet e saj dhe (iii) përpara Datës së Nënshkrimit të Kontratës. Shitësi do të ketë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfundimin e transaksioneve të parashikuara në këtë Kontratë;

b. Shitësi zotëron titull të ligjshëm pronësie mbi Pasurinë, të lirë nga çdo lloj barre ose hipoteke dhe/ose nga çdo pretendim pronësie i të tretëve;

c. Shitësi ka regjistruar Pasurinë në pronësi të tij në Zyrën(-at) Kompetente të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

d. Ndërmarrja e Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë nuk ka asnjë borxh ose detyrim tjetër ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Autoriteteve Tatimore, KESH-it, Ndërmarrjes së Ujësjellësit, Rezervave të Shtetit, Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit, Autoriteteve Doganore, Entit të Banesave, furnizuesit ARMO Sh.A. dhe çdo pale tjetër të tretë të angazhuar në marrëdhënie biznesi me Ndërmarrjen e Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë për periudhën deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës dhe Shitësi do të ndalojë dëmtimin e Blerësit dhe do ta ruajë atë të paprekur nga çdo pretendim i palëve të sipërpërmendura për detyrime të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë për periudhën deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës;

e. Nuk ekziston asnjë kontratë (me shkrim ose me gojë) e lidhur me palët e treta si qira, licenca, leje, franchising, koncesione ose kontrata të tjera të cilat ndikojnë mbi Pasurinë;

f. Dokumentet që Shitësi i ka dorëzuar Blerësit janë të vërteta e të sakta dhe nuk krijojnë bazë ligjore për ndonjë kundërshtim nga të tretët;

g. Pasuria, përdorimi i saj dhe gjendja në të cilin ndodhet nuk përbën shkelje të ndonjë ligji, rregulloreje, vendimi, urdhri dhe udhëzimi të aplikueshëm, akti kufizues ose mosmarrëveshjeje, akti për miratimin e ndonjë sheshi ndërtimi, rregulloreje për ndarje në zona urbane, plane studimi urbanistike të aplikueshme mbi Pasurinë.

h. Shitësi ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e institucioneve qendrore dhe lokale shtetërore, me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe me normat, rregulloret e urdhrat e të gjitha autoriteteve në lidhje me Pasurinë dhe përdorimin e saj të ligjshëm, si dhe veprimtarinë e kryer në lidhje me të.

i. Pasuria nuk është objekt i ndonjë vendimi gjykate, urdhri ose vendimi të Këshillit të Ministrave, i cili në vetvete është objekt i ndonjë padie ose procedimi i cili ngarkon me detyrime të çdo lloji qofshin Pasurinë dhe/ose Blerësin. Çdo pretendim padi e ngritur ndaj dhe lidhur me Ndërmarrjen e Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë nga të tretët përpara apo pas Datës së Nënshkrimit të Kontratës në lidhje me Pasurinë do të pranohet merret përsipër dhe zgjidhet nga Shitësi dhe/ose Shteti Shqiptar me shpenzimet e tyre.

j. Shitësi nuk ka lidhur ndonjë kontratë me Sindikatat e Punëtorëve ose me punëtorë individualë të cilat krijojnë detyrime për Blerësin pas Datës së Nënshkrimit të Kontratës;

k. Ndërmarrja e Prodhimit të Çimentos Fushë-Krujë zotëron të gjitha licencat, lejet dhe autorizimet që në bazë të ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave, urdhrave, normat e tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë, qofshin këto akte të pushtetit qendror apo lokal, janë të nevojshme për të zhvilluar veprimtarinë e saj në mënyrë të qetë dhe pa ndërhyrje. Këto licenca, leje dhe autorizime janë lirisht të transferueshme dhe do të transferohen te Blerësi në përputhje me pikën a të nenit 7 këtu më poshtë:

1. Asnjë veprim, pëlqim ose miratim për regjistrim pranë ndonjë autoriteti shtetëror nuk kërkohet në lidhje me transaksionet e përcaktuara në dokumentet e transaksionit përveç atyre që janë ndërmarrë dhe janë në fuqi.

Neni 6

Garancitë dhe përfaqësimet e përgjithshme të Blerësit

Blerësi deklaron, garanton dhe është dakord që:

a. Blerësi është një shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë me seli në Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr.24373, që ekziston në përputhje me legjislacionin shqiptar, e cila është e licencuar dhe e pajisur me të gjitha certifikatat, lejet dhe licencat përkatëse për të zhvilluar veprimtari të ligjshme në Shqipëri dhe është rregullisht e autorizuar e ka kompetenca të plota për të nënshkruar, dorëzuar dhe zbatuar këtë Kontratë:

b. Nënshkrimi, dorëzimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate dhe i Dokumenteve të tjera të Transaksioneve nga Blerësi (i) janë autorizuar nga ortakët e tij dhe (ii) nuk përbën shkelje të ligjit, të ndonjë urdhri të nxjerrë nga ndonjë autoritet shtetëror, të dokumenteve ligjore të blerësit ose të dispozitave të ndonjë marrëveshjeje që krijon detyrime ose të ndonjë marrëveshje tjetër në të cilën ai është palë ose përbëjnë shkelje në bazë të një marrëveshjeje të tillë. Kjo Kontratë e nënshkruar rregullisht ashtu, si dhe çdo Dokument tjetër Transaksioni në të cilin Blerësi është palë, kur të nënshkruhet, përbën një detyrim ligjor të vlefshëm dhe të ekzekutueshëm ndaj Blerësit në bazë të kushteve të parashikuara në të:

c. Asnjë veprim, pëlqim ose miratim për regjistrim pranë ndonjë autoriteti shtetëror nuk kërkohet në lidhje me transaksionet e përcaktuara në dokumentet e transaksionit përveç atyre që janë ndërmarrë dhe janë në fuqi.

d. Dokumentet që i janë paraqitur Shitësit janë të vërteta.

e. Në rast të moskrijimit të ndonjë pengese për shkak të sigurisë, Blerësi do të aktivizojë punën brenda 6 (gjatë) muajve dhe, pas shqyrtimit dhe zgjidhjes përfundimtare të çdo dhe të gjitha çështjeve gjyqësore të filluara dhe në shqyrtim që ndikojnë mbi Pasurinë, do të zbatojë programin e tij të investimeve.

Neni 7
Marrëveshje

a. Shitësi garanton se do t'i transferojë Blerësit të gjitha licencat, lejet dhe autorizimet të cilave u referohet paragrafi k, i nenit 5 më sipër, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë. Në rast se ndonjë nga lejet, licencat ose autorizimet mungon ose nuk është e transferueshme, Shitësi merr përsipër dhe garanton t'i nxjerrë ato në favor të Blerësit pranë autoriteteve kompetente.

b. Shitësi merr përsipër të mbrojë Blerësin nga dëmtimi dhe ta ruajë atë të paprekur nga efektet e vendimit të gjykatës në lidhje me çështjen e Syla Gërgurit, si dhe nga çdo vendim administrativ ose vendim gjykate në lidhje me çdo procedurë administrative ose çështjet gjyqësore në lidhje me Pasurinë objekt i kësaj Kontrate.

c. Shitësi garanton se përsa kohë që do të ekzistojë Fabrika e Çimentos Fushë-Krujë, zonat e guroreve, koordinatat e të cilave janë përcaktuar në Aneksin F bashkëngjitur kësaj Kontrate, do të rezervohet për përdorim dhe shfrytëzim ekskluziv nga Fabrika e Çimentos Fushë-Krujë dhe asnjë koncension, licencë ose leje nuk do t'i jepet ndonjë pale të tretë për këto zona.

d. Në rast të privatizimit, shitjes ose transferimit në çdo formë në të ardhmen të zonave të guroreve e karrierave të përshkruara në pikën c të këtij neni më sipër. Blerësi do të ketë të drejtën e parablerjes, si dhe të drejtën e refuzimit të parë përkundrejt çdo pale tjetër të interesuar.

Neni 8
Raste të Mospërmbushjes

Rastet e mëposhtme do të konsiderohen "Raste të Mospërmbushjes":

a. Çdo vendim gjyqësor i formës së prerë që deklaron Tenderin nëpërmjet të cilit Pasuria i transferohet Blerësit të paligjshëm ose të pavlefshëm dhe që ka si efekt final marrjen e pjesshme ose të tërë të Pasurisë nga Blerësi dhe/ose që sjell si pasojë humbje financiare si rezultat i sa më sipër.

b. Çdo vendim gjyqësor i formës së prerë që deklaron këtë Kontratë të paligjshme ose të pavlefshme, i cili ka si efekt final marrjen e Pasurisë pjesërisht ose tërësisht nga Blerësi në interes të ndonjë pale të tretë dhe që sjell si pasojë humbje financiare si rezultat i sa më sipër;

c. Çdo vendim gjyqësor i formës së prerë që i njeh tërësisht ose pjesërisht Pasurinë një pale të tretë dhe që sjell si pasojë humbje financiare si rezultat i sa më sipër, edhe pse një vendim i tillë nuk e shpall të pavlefshme këtë Kontratë në mënyrë eksplicite;

d. Çdo deklarim ose garanci e dhënë këtu, ose çdo përfaqësim, deklaratë ose informacion i pasqyruar në ndonjë vërtetim, pasqyrë financiare ose në ndonjë instrument tjetër të dhënë në lidhje me çdo Dokument Transaksioni, që do të provohet se nuk është i vërtetë, i pavlefshëm ose disorientues në çfarëdo drejtimi qoftë.

Neni 9
Zgjidhjet

Kur vërtetohet një Rast Mospërmbushjeje, Shitësi dhe Blerësi duhet të negociojnë për të gjetur një rrugëzgjidhje të pranueshme për të dyja palët për korrigjimin e Rastit të Mospërmbushjes. Në qoftë se palët nuk arrijnë të gjejnë me negocim një zgjidhje të pranueshme për to, Blerësi pa asnjë detyrim për të filluar ndonjë proces gjyqësor, ka të drejtë të tërheqë çmimin e shitblerjes nga Shitësi.

Neni 10
Tërësia e Kontratës

Kjo Kontratë bashkë me Anekset bashkëngjitur dhe çdo Dokument tjetër të Transaksionit përbëjnë të gjithë marrëveshjen e lidhur midis palëve në lidhje me objektin e kësaj kontrate. Çdo marrëveshje e mëparshme midis palëve në lidhje me objektin në fjalë është zëvendësuar nga kjo Kontratë dhe Dokumentet e tjera të Transaksionit. Asgjë në këtë Kontratë apo në ndonjë Dokument tjetër Transaksioni e shprehur ose e nënkuptuar, nuk synon që t'i kalojë ndonjë pale të ndryshme nga palët e kësaj Kontrate ndonjë të drejtë, zgjidhje, detyra apo përgjegjësi.

Neni 11
Pavlefshmëria

Në rast se një ose më shumë nga dispozitat e parashikuara në këtë Kontratë ose në ndonjë nga Dokumentet e Transaksionit do të rezultojë e pavlefshme, e paligjshme ose e paekzekutueshme, dispozitat e tjera të cilat janë të vlefshme, të ligjshme dhe të ekzekutueshme do të mbeten në fuqi. Palët do të negociojnë në mirëbesim me njëra-tjetrën për zëvendësimin e dispozitave të pavlefshme, të paligjshme ose të paekzekutueshme me dispozita, ndikimi ekonomik i të cilave duhet t'i afrohet sa më shumë të jetë e mundur atij të dispozitave të pavlefshme, të paligjshme ose të paekzekutueshme.

Neni 12
Ligji i Aplikueshëm dhe Arbitrazhi

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar të aplikueshëm për kontratat e lidhura me Shqipëri.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, shkeljen dhe përfundimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit. Arbitrimi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e përdorshme në proces do të jetë gjuha angleze. Palët e kësaj Kontrate bien dakord të përjashtojnë aplikimin e ndonjë rregulli të veçantë dhe deklarojnë se ata njohin Rregullat e Pajtimit dhe të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Neni 13
Autorizimet

Të gjitha autorizimet, pëlqimet, urdhrat ose miratimet ose depozitimet ose skadimi i afateve të periudhave pritëse, të vendosura nga ndonjë entitet ose autoritet qeveritar, të nevojshme për realizimin e shitjes do të jenë marrë, depozituar ose të jenë lëshuar, ose sipas rastit. Autoriteti kompetent do të ketë hequr dorë prej tyre. Në mënyrë të veçantë, me kërkesën e Shitësit, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë do të marrë vendimin për ta paraqitur këtë Kontratë për ratifikim në Kuvend. Për shmangien e ndonjë dyshimi, kuptohet që kjo Marrëveshje është e saktë dhe e plotë (perfekte), hyn në forcë dhe zbatohet me nënshkrimin e saj, e vlefshme dhe efektive që nuk varet prej ratifikimit të saj ose jo nga Parlamenti.

Neni 14
Gjuha e Kontratës

Kjo Kontratë përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) faqe është hartuar në 5(pesë) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe në 5(pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

Në rast mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me interpretimin e kësaj Kontrate, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Kontrata iu lexua Palëve prej meje, Noterit, me zë të qartë dhe të kuptueshëm dhe Palët, pas deklarimit se e gjejnë këtë Kontratë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e nënshkruajnë Kontratën në praninë time dhe unë Noteri, vërtetoj këtë Kontratë dhe nënshkrimet e Palëve sipas ligjit.

SHITËSI	BLERËSI
Përfaqësuar nga	Përfaqësuar nga

NOTERI

D E K R E T
Nr.2839, datë 21.12.2000

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Genci Themistokli Bimbli
2. Margarita Argjir Bimbli (Argjiriu)
3. Iva Genci Bimbli
4. Patris Genci Bimbli
5. Sadik Aziz Huda
6. Enkelejda Nikolin Sava
7. Xhehanger Zylbehar Gostivari
8. Hava Omer Gostivari
9. Fatmir Xhehanger Gostivari
10. Lulzim Xhehanger Gostivari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.30/6, datë 14.11.2000

PER DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN LOKAL PRIVAT
"TV A 1"

SUBJEKTIT: SHOQËRIA "TV BALLKAN" SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr.8655, date 31.07.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë"", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "TV BALLKAN" sh.a.licencë duke e autorizuar të funksionojë

si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Anëtari Pashk Përvathi është i mendimit se Shqipëria në momentin e tanishëm është e përgatitur vetëm për një licencë private kombëtare për të krijuar mundësinë e licencimit të operatorit të dytë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001.

V E N D I M
Nr.30/10, datë 14.11.2000

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN LOKAL PRIVAT
"TV ALBA"

SUBJEKTIT: SHOQËRIA "ALBA TV" SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë"", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "ALBA TV " sh.a. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* Anëtari Pashk Përvathi është i mendimit se Shqipëria në momentin e tanishëm është e përgatitur vetëm për një licencë private kombëtare për të krijuar mundësinë e licencimit të operatorit të dytë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001.

V E N D I M
Nr.30/13, datë 14.11.2000

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN LOKAL PRIVAT
"TV ATN 1"

SUBJEKTIT: SHOQËRIA "MEDIASAT " SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë"", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "MEDIASAT" sh.a. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë 5

vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* Anëtari Pashk Përvathi është i mendimit se Shqipëria në momentin e tanishëm është e përgatitur vetëm për një licencë private kombëtare për të krijuar mundësinë e licencimit të operatorit të dytë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001.

V E N D I M
Nr.31/3, datë 11.12.2000

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN LOKAL PRIVAT
"TV BESËLIDHJA"

SUBJEKTIT: Z. FRANO KULLI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë"", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

